

# RAPORT STUDIMOR

## INFORMIMI, NJOFTIMI DHE KONSULTIMI PUBLIK NGA PUSHTETI VENDOR

BASHKIA DURRËS



QENDRA E ZHVILLIMIT TË SHOQËRISË CIVILE DURRËS  
QERSHOR 2022

## Tabela e përmbajtjes

Hyrje.....	2
Lista e shkurtimeve .....	4
Profili i Bashkisë Durrës .....	5
Metodologjia.....	6
Analizë e formave të njoftimit, informimit dhe konsultimit publik.....	8
Gjetjet nga anketimi me përfaqësuesit e Bashkisë .....	8
Gjetjet nga anketimi me përfaqësuesit e Këshillit Bashkiak.....	
Konkluzione.....	
Rekomandime .....	

## 1. HYRJE

Raporti studimor “Informimi, Njoftimi dhe Konsultimi Publik nga pushteti vendor” kryhet në kuadër të projektit “Përballja e Ofertave Politike – POP”. Ajo është një nismë e rrjetit të 12 organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga Olof Palme International Centre në kuadër të një programi të financuar nga Suedia: “Shoqëria Civile, Pjesëmarrja Qytetare, Llogaridhënia dhe Ndryshimi Social” dhe nga National Endowment for Democracy.

Gjatë vitit 2019 janë hartuar kontratat sociale për 9 bashki (Tiranë, Durrës, Shkodër, Fier, Vlorë, Kamëz, Pogradec dhe Pukë) dhe që prej atij viti rrjeti “Përballja e Ofertave Politike” monitoron zbatimin e tyre përmes dy projekteve që shkrihen te njëri – tjetri të financuara nga Olof Plame International Centre (OPIC) dhe National Endowment for Democracy (NED).

Në vitin 2021, Rrjeti POP u zgjerua duke shtuar edhe bashkitë Elbasan, Vau i Dejës dhe Korçë. Tre Kontrata Sociale u nënshkruan në bashkitë e mësipërme duke vijuar kështu monitorimin për zbatimin e tyre në 12 bashki. Nëpërmjet këtij projekti Rrjeti POP, synon të forcojë bashkëpunimin me qytetarët në përfshirjen e tyre në vendimmarrje në nivel vendor, duke qenë një urë lidhëse mes tyre (qytetarëve) dhe pushtetit vendor për sa i përket transparencës, llogaridhënies dhe demokracisë vendore.

Organizatat e Rrjetit POP gjatë periudhës maj -qershor 2022 realizuan pyetësorë me stafet përkatëse ne Bashki dhe me përfaqësues të Këshillave Bashkiakë dhe përgjigjet e marra nga pyetësorët u përballën me analizën e bërë nga vetë shoqatat sa i përket gjendjes aktuale në secilën bashki në lidhje me menyrën se si realizohet dhe mjetet e format që bashkitë përdorin për njoftimin, informimin dhe konsultimin e publikut.

Kjo analizë tregoi që bashkitë i vlerësojnë këto procese dhe përpiqen të përdorin mjete dhe forma të ndryshme për të patur qytetarët dhe qytetaret pjesë të veprimtarisë dhe vendimmarrjes së tyre por ka dhe sfida që duhen tejkaluar e mangësi të cilat duhen përmirësuar.

Për shembull faqet zyrtare të bashkive duhen të jenë më miqësore për publikun, regjistri i kërkesë ankesave duhet të përditësohet vazhdimisht, programet e transparencës duhet të jenë lehtësisht të aksesueshme dhe të konsultohen me qytetarët, bashkitë duhet të përdorin një numër të konsiderueshëm mjetesh dhe formash për njoftimin dhe informimin e qytetarëve. Proceset e konsultimeve realizohen në bashkitë pjesëmarrëse por më shumë duhet te punohet për rritjen dhe nxitjen e interesit të qytetarëve për të marrë pjesë dhe për t’u përfshirë në sa më shumë takime e dëgjesa publike, përfshirë procesin e hartimit të projekt-buxheteve.

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët, si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve rrjeti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Është një përpjekje për të rritur hapësirat për debate publike dhe informacione të qytetarëve në lidhje me platformat e politikave nga njëra anë dhe duke i orientuar këto platforma drejt nevojave dhe përparësive të komunitetit nga ana tjetër.

Organizatat partnere të rrjetit janë: Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim” Tiranë; Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës; Qendra Rinore Vlorë; Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Kamëz; Epoka e Re, Fier; Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër; Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë; Qendra Rinore për Progres, Kukës, Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim, Progradec, Gruaja në Zhvillim Korçë; Tjetër Vizion Elbasan dhe Qendra “Hapa të Lehtë” Vau i Dejës.

## 2. LISTA E SHKURTIMEVE

BP	Buxhetimi me Pjesëmarrje
BPGJ	Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjijnor
KB	Këshilli Bashkiak
KKQV	Komisione Këshillimore Qytetare Vendore
GADC	Gender Alliance Development Center
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NED	National Endowment for Democracy
NJVQV	Njësi e Vetëqeverisjes Vendore
OPIC	Olof Plame International Centre
OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
QV	Qeverisje Vendore
RAT	Reforma Administrativo-Territoriale

### 3. PROFILI I BASHKISË DURRËS

*Profili i Bashkisë – I referohet të dhënave të përgjithshme dhe specifike për Bashkinë Durrës, siç janë shtrirja, popullsia, aktiviteti ekonomik, kulturor dhe turistik.*

Që prej Reformës Administrativo-Territoriale të vitit 2015, Bashkia Durrës përbëhet nga 6 njësi administrative, të cilat janë: Durrësi, Sukthi, Ishmi, Katundi i Ri, Rrashbulli dhe Manëz. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Durrësit dhe Qarkut Durrës. Bashkia ka nën administrimin e saj 1 qytet dhe 39 fshatra.

#### **Popullsia**

Sipas Censurit të vitit 2011, në territorin e Bashkisë Durrës banojnë 175,110 vetë, ndërsa duke iu referuar Regjistrimit Civil popullsia rezidente është 299,989 vetë. Me një sipërfaqe prej 338.30 km<sup>2</sup>, densiteti i popullsisë sipas të dhënave të Censurit 2011 është 517 banorë/km<sup>2</sup> ndërsa sipas Regjistrimit Civil është 680 banorë/km<sup>2</sup>.

#### **Pozicioni Gjeografik**

Bashkia e Durrësit shtrihet përgjatë bregut të detit, nga grykëderdhja e lumit Ishëm në veri deri në kufi me Kavajën në jug, në një sipërfaqe prej 338.30 km<sup>2</sup>. Vija e gjatë bregdetare që i shtohet qytetit të Durrësit e thekson tiparin e kësaj bashkie si zonë turistike, pasi përveç plazhit të Durrësit asaj i shtohet i gjithë gjiri i Lalëzit si dhe Kepi i Rodonit, të cilat deri tani kanë qenë pjesë e komunave Ishëm, Sukth, Katund i Ri dhe Rrashbull.

Durrësi ka portin më të madh në Shqipëri, ku përpunohet mbi 90 për qind e të gjithë volumit të ngarkim-shkarkimit portual, gjë që e bën atë një nga më të rëndësishme tregtare në vend. Për shkak të lehtësisë që krijon porti, Durrësi është zhvilluar edhe si një qytet i rëndësishëm për manifakturën, ndërsa joshja nga turizmi ka shkaktuar gjatë dy dekadave të fundit një bum në sektorin e ndërtimit. Durrësi është një zonë me shkallë të lartë të migrimit të brendshëm, gjë që ka sjellë zgjerimin e shpejtë dhe informal të qytetit në zonën e ish-Kënetës si dhe përgjatë vijës bregdetare në jug të qytetit.

Durrësi është gjithashtu një zonë e rëndësishme arkeologjike, pasi nën qytetin aktual gjenden disa shtresa qytetërimesh antike. Zbulimet arkeologjike janë të shumta, ndërsa ndërtimet e dekadave të fundit kanë dëmtuar një pjesë të kësaj trashëgimie.

#### **Turizmi dhe ekonomia**

Me mbi 5600 aktivitetet ekonomike të tij dhe 15% të investimeve të huaja, Durrësi është renditur në vendin e dytë si ekonomia më e fortë e vendit, pas Tiranës.

Turizmi veror dhe kulturor është një industri me ndikim të rëndësishëm në ekonominë e Durrësit. Me mbi 750.000 vizitorë në vit, kjo është zona më e rëndësishme e vendit në lidhje me turizmin masiv. Sipas Zyrës Rajonale të Punës të Durrësit, forcat aktive për të

punuar llogariten rreth 54,000 njerëz. Niveli i të papunëve për rrethin e Durrësit shkon në rreth 10,38%, ku papunësia është më e përhapur te femrat. Sektori privat ka punësuar rreth 31,3%, i ndjekur nga sektori bujqësor privat me 36,7%, dhe sektori shtetëror me 21.3%.

### **Kompozimi i Bashkisë**

Bashkia Durrës përbëhet nga gjashtë njësi administrative, të cilat janë: Durrësi, Sukthi, Ishmi, Katundi i Ri, Rrashbulli dhe Manëz. Në Bashkinë Durrës ka 346 punonjës.<sup>1</sup> Secila prej Njësive Administrative ka 3 punonjës kryesorë të paraqitur në strukturën organizative të bashkisë, administratori dhe inspektorët. Këshilli Bashkiak është i përbërë nga 51 këshilltarë, Kryetari, Zv/Kryetari dhe Sekretari i Këshillit.<sup>2</sup>

---

<sup>1</sup> <https://www.durres.gov.al/bashkia/administrata/829-struktura-dhe-pagat>

<sup>2</sup> <https://www.durres.gov.al/bashkia/keshilli-bashkiak/134-struktura-e-keshillit-bashkiak/1180-struktura-e-keshillit-bashkiak>

## 4. METODOLOGJIA

Për hartimin e raportit mbi situatën e informimit, njoftimit dhe konsultimit publik në Bashkinë Durrës janë kërkuar dhe përdorur një seri teknikash dhe instrumentash, të tilla si: a) hartimi i metodologjisë dhe instrumentit të anketimit (dy pyetësorë); b) kërkim dhe analizim të informacionit, dokumentave (fizikë dhe elektronikë) dhe kuadrit rregullator e ligjor përkatës; c) intervista të thelluara me stafin e bashkisë dhe anëtarë të Këshillit Bashkiak; d) analizim dhe përpunim të të dhënave të anketimit dhe e) përgatitja e raportit së bashku me rekomandimet përkatëse.

Ekspertët e projektit e bazuan procesin e kërkimit dhe analizimit në tërësinë e informacionit dokumentacionit dhe praktikave, të përdorura në procese të ndryshme të njoftimit, informimit, konsultimit dhe angazhimit të komunitetit në bashkëqeverisje dhe vendimarrje. Procesi i kërkimit dhe analizimit u shtri si në dokumencionin ekzistues zyrtar, ashtu edhe në kuadrin respektiv rregullator e ligjor, të tilla si Ligji Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligji Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, Ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, etj. Identifikimi dhe analiza e burimeve ekzistuese tregoi se ka pak informacion dhe të dhëna të disonueshme mbi praktikën e njoftimit dhe përfshirjes qytetare në qeverisjen vendore.

Pamjaftueshmëria e informacionit të disponueshëm mbi çështjen në fjalë, theksoi rëndësinë e procesit të anketimit me të gjithë hallkat e veta (hartimi i metodologjisë, përcaktimi i rubrikave dhe informacionit që duhej mbledhur dhe analizuar, dhe format e mjetet që do të përdoshin për kryerjen e tij). Metoda kryesore për realizimin e studimit është ajo sasiore, që nënkupton përdorimin e pyetësorëve për mbledhjen e të dhënave. Anketimi përdori gjerësisht elemente të vlerësimit cilësor nëpërmjet pyetjeve të hapura dhe shpjeguese me qëllim eksplorimin e instrumenteve dhe proceseve që sigurojnë angazhim dhe gjithë përfshirje të komuniteteve në pushtetin vendor. Metodologjia e studimit mbart elementë të fortë të vlerësimit informativ.

Pjesë e këtij anketimit janë bërë drejtues, stafe teknike dhe këshilltarë vendorë të 12 bashkive të madhësive të ndryshme të përfshira në programet shumë vjeçare që Olof Palme ka zbatuar në vend. Për anketimin u hartuan dy pyetësorë me pyetje shteruese cilësore dhe sasiore, të cilat mbulojnë një gamë të gjerë temash dhe çështjesh. Për përgatitjen e pyetësorëve u konsultuan paraprakisht ligjet, rregulloret dhe udhëzimet përkatëse që përbëjnë kuadrin ligjor dhe institucional mbi informimin, njoftimin dhe konsultimin qytetar në nivel vendor.

Faza përmblyëse përfshiu hedhjen, përpunimin statistikor, studimin dhe analizimin e të dhënave, si dhe përgatitjen e këtij raportit përfundimtar.



## 5. ANALIZË E FORMAVE TË NJOFTIMIT, INFORMIMIT DHE KONSULTIMIT PUBLIK

Sipas vëzhgimeve të bëra, Bashkia Durrës përdor tre forma kryesore për informimin dhe njoftimin, të cilat janë më të përditësuarat, më të shpeshtat dhe më të përhapurat tek qytetarët:

- **Këndet e informimit pranë ambjenteve të Bashkisë** – Forma më e thjeshtë dhe bazike, ku janë të afishuara njoftimet e fundit dhe më kryesoret. Ana pozitive është që kjo lloj forme është e aksesueshme kryesisht për grupmoshën e tretë, por nuk ka të publikuar çdo vendim, ashtu si në faqen e ëeb apo mediat sociale.
- **Faqja zyrtare e Bashkisë Durrës** – është e përditësuar rregullisht, me njoftimet për mbledhjet e Këshillit Bashkiak, çështjet e diskutuara dhe vendimet e marra në mbledhjet e Këshillit Bashkiak, rendin e ditës dhe çdo njoftim në datën përkatëse të po asaj dite. Megjithëse mbart njoftimet më të fundit dhe sasi të konsiderueshme informacioni, nuk është e aksesueshme nga të gjithë qytetarët dhe terminologjia e përdorur mund të mos jetë e kuptueshme nga të gjithë.
- **Mediat sociale (Facebook dhe Instagram)** – Faqja e Facebook, ashtu si dhe faqja e web, është aktive dhe ka njoftimet më të fundit. Përmban thuajse çdo informacion që gjendet në faqen e ëeb, informacione të cilat postohen në formë *link* apo artikulli. Gjithashtu ka postime, ku demonstrohen me foto dhe të shpjeguara në formë teksti aktivitetet aktuale që kryhen nga Bashkia Durrës me pjesëmarrjen e Kryetares apo aktorëve të tjerë të rëndësishëm. E njëjta gjë vlen dhe për faqen e Instagram, por nuk është po aq aktive dhe e përditësuar me njoftime apo vendime, ashtu si media sociale (FB) e përmendur më parë.

Për konsultimin me qytetarët, Bashkia Durrës kryen dëgjesa publike dhe në parim i fron edhe në mbledhjet e Këshillit Bashkiak. Megjithatë, nga të dhënat e deritanishme, këto informacione jo gjithmonë mbërrijnë te qytetarët. Gjithashtu një pjesë nuk e dinë që e kanë këtë të drejtë, ndaj nuk kërkojnë informacion në lidhje me datat e ardhshme të mbledhjes së Këshillit Bashkiak apo dëgjësave publike.

Në këtë pikë mund të thuhet që problemi nuk qëndron vetëm në format e konsultimit që përdor Bashkia, por në informacionin e cunguar që ka dhënë te qytetarët, duke mos marrë në konsideratë që jo të gjithë kanë akses në faqen e web apo mediat e tyre sociale.

## 6.1 GJETJET NGA ANKETIMI ME PËRFAQËSUESIT E BASHKISË

Kuadri ligjor në fuqi parashikon një sërë detyrimesh dhe përgjegjësish në lidhje me format dhe mjetet që institucionet publike duhet të venë në dispozicion të pjesëmarrjes së publikut dhe grupeve të interesit në procesin e informimit, njoftimit dhe përfshirjes së tyre në konsultim e vendimarrje.

Për të parë ecurinë e këtyre proceseve në respekt edhe detyrim të ligjit dhe qytetarëve, u zhvillua një anketim me 14 përfaqësues të Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak Durrës. Anketimi synon të evidentojë dhe sjellë në vëmendje situatën aktuale të pjesëmarrjes qytetare në proceset konsultuese dhe vendimmarrëse si dhe të analizojë të gjitha format dhe instrumentat që institucioni i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak përdorin për sjelljen më pranë të qytetarëve në bashkëqeverisje.

Tetë të intervistuarit nga institucioni i Bashkisë janë: Nënkryetari i Bashkisë Koordinatori për Informim dhe Koordinatori për Konsultim Publik, Drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe katër administratorë të Njësive Administrative Nr. 2, Nr. 6, Ishëm dhe Katund i Ri.


### Njoftimi, Informimi dhe Konsultimi Publik në Nivel Vendor



Ashtu si tregohet dhe në grafikun e mësipërm, për pjesën më të madhe të të anketuarve (83.3%), procesi i njoftimit të qytetarëve në vendimarrjen vendore konsiderohet si shumë i rëndësishëm.

Informimi dhe konsultimi janë po ashtu të së njëjtës rendësi për pjesëmarrësit. Nga anketimi rezulton si mëposhtë:

- 83% - Shumë e rëndësishme
- 16.7% - E rëndësishme



Nga të dhënat duket se pjesa më e madhe e të anketuarve (66.7%), raportojnë që kanë njohuri të mira mbi bazën ligjore për njoftimin, informimin dhe konsultimin në vendimarrjen vendore, kundrejt një numri më të vogël (1/3 e të intervistuarve) që kanë njohje shumë të mirë të saj.

- 66.7% - Mirë
- 33.3% - Shumë mirë

### Kuadri ligjor për njoftimin, informimin dhe konsultimin në nivel vendor

Për sa i përket vlerësimit mbi kuadrin ligjor, gjysma e të anketuarve janë të mendimit që ky kuadër është i qartë dhe i plotë, ndërsa gjysma tjetër e gjykojnë si të qartë, por jo të plotë.


Sipas rekomandimeve të bërë prej të anketuarve, përmbajtja e kuadrit ligjor duhet të jetë sa më e qartë dhe e thjeshtuar që të kuptohet dhe nga publiku i thjeshtë.



- 50% - Është i qartë dhe i plotë
- 50% - Është i qartë, por jo i plotë

### Njoftimi, Informimi dhe Konsultimi në Vendimmarrjen Vendore

Në lidhje me mjetet që përdoren për njoftimin e qytetarëve për përfshirjen e tyre në vendimarrje, raportohet që më së shumti përdoren lajmërimet publike të afishuara në ambientet e Bashkisë dhe mediat sociale (40%), duke u pasuar në një përdorim më pak të




shpesh të lajmërimit nëpërmjet postës, postës elektronike dhe në mediat audio-vizive (6.7%). Rezultatet janë si më poshtë:

- 40% - Lajmëri publik afishuar në ambjentet e Bashkisë
- 40% - Lajmërin në mediat sociale (Facebook, etj.)
- 6.7% - Lajmërim individual përmes postës
- 6.7% - Lajmërim individual përmes postës elektronike
- 6.7% - Lajmërim në mediat audio-vizive lokale

Të pyetur për shifrat konkrete se sa njoftime janë publikuar gjatë vitit 2021 në tabelat e lajmërimeve dhe online, vetëm një nga të anketuarit jep një shifër të hamendësuar (rreth 70 njoftime). Një tjetër i anketuar sugjeron konsultimin me faqen zyrtare të Bashkisë, ndërsa të anketuarit e tjerë (n=4) nuk kanë dhënë përgjigje.

### Instrumentat për Informimin e Qytetarëve



Ashtu si në pyetjen rreth mjeteve që përdoren për njoftim, dhe tek ato të cilat përdoren për informim, raportohet mbizotërimi i përdorimit të këndeve të informimit, pasuar nga faqja zyrtare e Bashkisë (dhe mediat sociale. Më pak të përdorura janë Zyrat me Një Ndalesë, materialet informuese dhe mediat audio-vizive lokale.

- 30% - Këndet e informimit në ambjentet e Bashkisë
- 25% - Faqja zyrtare e Bashkisë
- 20% - Mediat sociale
- 10% - Materiale informuese (fletë palosje, etj.)
- 10% - Zyrat me Një Ndalesë (One Stop Shop)
- 5% - Mediat audio-vizive lokale

### Koordinatori për Njoftimin, Konsultimin Publik dhe Koordinatori Transparencën

Për pyetjet nëse ka koordinator/e për njoftimin, konsultimin publik dhe trasnparencën në Bashki dhe a është ky i vetmi pozicion që mbulohet prej tij/saj, gjysma e të anketuarve (n=4) i kanë qarkuar të dyja opsionet e përgjigjeve, duke i bërë përgjigjet të pavlefshme,

ndërkohë që dy prej tyre raportojnë që ka koordinator për njoftimin dhe konsultimin publik dhe një anketues raporton që nuk ka. Sipas këtyre të dhënave, përgjigja mbetet e paqartë dhe nuk mund të dilet në një konkluzion. Nëse ka koordinator/e në për çështje të transparencës, të gjithë të anketuarit (n=8) janë përgjigjur që nuk ka një individ që mbulon një pozicion të tillë. *Nga kërkimet tona rezulton që në Bashkinë Durrës ka koordinator për informimin dhe koordinator për konsultimin publik.*

### **Regjistri elektronik dhe publikimi i tij online**

Në lidhje me regjistrin elektronik, 62.5% e të anketuarve (n=5) përgjigjen që ka një të tillë dhe përgjegjëse për të janë kabineti dhe zyrat e IT, ndërkohë që nuk e dinë nëse është i publikuar online apo jo. Pjesa tjetër e të anketuarve, ose janë përgjigjur që nuk ka një të tillë, ose pa përgjigje, duke e bërë të vështirë të gjykohet nëse nuk ekziston një i tillë apo ka mungesë informacioni tek punonjësit. *Nga kërkimet tona, rezulton që ka një regjistër elektronik dhe është i publikuar online në faqen zyrtare të Bashkisë, më i fundit ai i vitit 2022.*

### **Raportet vjetore në lidhje me transparencën në procesin e vendimarrjes**

Për sa i përket raporteve vjetore në lidhje me transparencën në procesin e vendimarrjes, 37.5% e të anketuarve (n=3) raportojnë që janë hartuar dhe publikuar raporte të tilla, në të cilat përfshihet informacion në lidhje me numrin e akteve të miratuara nga Bashkia përgjatë vitit dhe numrin e takimeve publike të organizuara. *Nga kërkimet tona rezulton që janë hartuar raporte të tilla dhe janë të publikuara në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës.*

### **Sfidat/vështirësitë dhe sugjerimet për përmirësim**

Ndër sfidat dhe vështirësitë e ndeshura për njoftimin dhe informimin publik përmenden:

- Në njesite administrative me shtrirje territoriale të gjerë ka vështirësi të mëdha në informim, pasi jo të gjithë përdorin mjetet e komunikimit elektronik;
- Në zonat me sipërfaqe të gjerë, ku fshatrat janë në distancë, qytetarët neglizhojnë të shkojnë pranë njësisë të marrin informacion;
- Neglizhenca e përgjithshme e qytetarëve.

Sugjerimet për të përmirësuar sfidat e sipërpërmendura, ishin:

- Të bëhen takime dhe me banorët në zona të thella dhe t'u krijohet mundësia që të informohen, të keshillohen ose t'u mesohet si të veprojnë;
- Në çdo qendër fshati të vendoset ose instalohet një tabelë informuese për të vendosur njoftimet e vazhdueshme;
- Të ketë fushata sensibilizuese.

## Trajnimet në lidhje me detyrimet ligjore për informimin publik



Një gjetje tjetër interesante, është në lidhje me trajnimet që kanë fokus detyrimet ligjore për informimin publik, ku gjysma e të anketuarve (n=4) raporton që nuk kanë marrë trajnime të kësaj natyre.


50% - Po (kanë marrë trajnim)

50% - Jo (nuk kanë marrë trajnim)

## 6.2. GJETJE NGA ANKETIMI ME KËSHILLAT BASHKIAKË

Në total janë 3 të anketuar, specifikisht me: Zv/Kryetarja e Këshillit Bashkiak, Sekretarja e Këshillit Bashkiak dhe një anëtar i KB


### Njoftimi, informimi dhe Konsultimi në Vendimarrjen Vendore



Rëndësia e njoftimit, informimit dhe konsultimit në vendimarrjen vendore është vlerësuar maksimalisht nga 2 prej 3 të anketuarve. Gjithashtu, informimi dhe konsultimi në lidhje me proceset vendimarrëse, janë po ashtu të së njëjtës rëndësi për pjesëmarrësit si më poshtë:


- 66.7% - Shumë i rëndësishëm
- 33.3% - I rëndësishëm

### Kuadri ligjor për njoftimin, informimin dhe konsultimin në vendimarrje



Njohja e bazës ligjore për njoftimin, informimin dhe konsultimin është shumë e mirë për shumicën e të anketuarve (2 prej 3). Përgjigjet janë si më poshtë:


- 66.7% - Shumë mirë
- 33.3% - Disi




Sipas të gjithë të anketuarve (n=3), kuadri ligjor mbi njoftimin dhe informimin e publikut në nivel vendor është i qartë dhe i plotë.

## Vlerësimi për rregulloret e Këshillit Bashkiak

Sipas të gjithë të anketuarve (n=3), rregulloret e Këshillit Bashkiak janë të qarta dhe të plota.



## Publikimi i akteve të Këshillit Bashkiak




Publikimi i akteve të Këshillit Bashkiak, sipas raportimeve, bëhet më së shumti në faqen zyrtare të internetit, dhe, me një diferencë shumë të vogël, në vende publike të caktuara nga Këshilli, me akses të lirë publik.

- 60% - Në faqen zyrtare të internetit
- 40% - Në vende publike të caktuara nga Këshilli, me akses të lirë publik

## Instrumentat për njoftimin dhe informimin e publikut

Për sa i përket mjeteve që përdor Këshilli Bashkiak për njoftimin e publikut, të raportuara më së shumti janë lajmërimi publik afishuar në ambientet e Bashkisë (25%) dhe lajmërimet në mediat sociale (25%), pasuar me një diferencë shumë të vogël nga mënyrat e tjera: lajmërimi individual përmes postës / postës elektronike dhe lajmërim në mediat audio-vizive lokale.





- 25% - Lajmërim publik afishuar në ambjentet e Bashkisë
- 25% - Lajmërim në mediat sociale
- 16.7% - Lajmërim individual përmes posters elektronike
- 16.7% - Lajmërim individual përmes postës apo takimeve direkte
- 16.7% - Lajmërim në mediat audio-vizive lokale

Të gjithë të anketuarit (n=3) raportojnë se **ka bashkëpunim ndërmjet Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak** për procesin e njoftimit dhe informimit, publikimi i njoftimeve bëhet në vende të caktuara për këtë qëllim dhe njoftimi përmban datën, vendin, orën, dhe rendin e ditës së mbledhjes. Ky bashkëpunim realizohet duke ftuar Këshillin Bashkiak në çdo konsultim, për më tepër në konsultime që janë të nevojshme përpara miratimit të një VKM.

2 nga 3 të anketuarit raporton që **Këshilli Bashkiak nuk i ka burimet e nevojshme për realizimin e njoftimit dhe informimit të publikut.**

Të gjithë të anketuarit (n=3) konstatojnë **ekzistencën e një regjistri elektronik të publikuar dhe perditesuar rregullisht.**

Të gjithë të anketuarit (n=3) raportojnë se **hartohet dhe publikohet një program transparence nga Bashkia**, si dhe **hartohen dhe publikohen raporte vjetore të punës së Këshillit Bashkiak.**

2 nga 3 të anketuarit përgjigjen se marrin trajnime në lidhje me detyrimet ligjore për informimin e publikut. Sugjerohet që të ketë trajnime më të shpeshta, pasi pjesa më e madhe e anëtarëve të Këshillit Bashkiak, janë të rinj.

## 6. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

- Proceset e njoftimit, informimit dhe konsultimit publik vlerësohen nga Bashkisa dhe Këshilli Bashkiak Durrës si procese shumë të rëndësishme.
- Strukturat kryesore në Bashki, të cilat ndihmojnë në informimin e publikut janë: këndet e informimit në ambjentet e Bashkisë, faqja zyrtare e Bashkisë dhe mediat sociale.
- Bashkia Durrës ka një regjistër elektronik të publikuar online, i cili përditësohet çdo vit.
- Raportet vjetore në lidhje me transparencën në procesin e vendimarrjes, hartohen dhe publikohen çdo vit nga Bashkia Durrës.
- Pavarësisht arritjeve të deritanishme, realizimi i procesit të konsultimit publik ka ende nevojë për përmirësime. Kjo mund të arrihet duke nxitur interesin e qytetarëve dhe duke krijuar infrastruktura që mundësojnë informimin sa më gjithëpërfshirës dhe të aksesueshëm nga të gjithë.
- Nëpunësit e Bashkisë dhe anëtarët e Këshillit Bashkiak duhet të marrin trajnime të vazhdueshme në lidhje me detyrimet ligjore për informimin e publikut. Në këtë mënyrë mundësohet aftësimi i vazhdueshëm i tyre në lidhje me këtë kuadër ligjor dhe ndihmon në procesin e komunikimit dhe transparencës.

---

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga “Olof Palme International Center” dhe “National Endowment for Democracy.” Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:

- Qendra “Aleanca Gjimore për Zhvillim”, Tiranë;
- Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës;
- Qendra Rinore Vlorë,
- Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Kamëz;
- Epoka e Re, Fier;
- Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër;
- Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë;
- Qendra Rinore për Progres, Kukës,
- Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim, Progradec;
- Gruaja në Zhvillim, Korçë;
- Hapa të Lehtë, Vau i Dejës;
- Tjetër Vizion, Elbasan